

Titulli i lëndës: PROJEKTIM - QENDRAT E KOMUNITETIT

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Hyrje në Projektimin e Objekteve Publike
Niveli:	Bachelor i Arkitekturës(BA)
Statusi i lëndës:	4
Viti i studimeve:	Sipas orarit
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof.Asst. Flaka Xërxa Beqiri
Të dhënat kontaktuese:	Email: flaka.xerxa@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<i>Arkitektura e komunitetit do të thotë një mjedis i ndërtuar që i ofrohet komunitetit, përfiton ose stimulon pjesëmarrjen e komunitetit në një kuptim thellësisht shoqëror dhe gjithëpërfshirës. Këto janë ndërtesa të përhershme dhe të përkohshme në nivelin e qytetit - hapësira publike, sheshe, panaire dhe ndërtesa arkitekturore të komunitetit. Është e zakonshme të shohësh qendrat e komunitetit që përdoren në pjesë të ndryshme të botës. Ato kanë përmbushur kërkesat e bashkësive për hapësira të ndryshme për shumë qëllime siq janë: institucionet shoqërore, institucione jashtëshkollore, qendrat komunitare, pavione ekspozuese dhe panaire, ambiente sakrale, varreza, qendra gerontologjie, sanatoriume, krematoriume dhe komplekse përkujtimore. Në ditët e sotme, qendrat e komunitetit kanë nevojë për përmbajtje, të cilat do të marrin parasysh nevojat e të gjitha grupmoshave në komunitet, mjedisit, qëllimit dhe qëndrueshmërisë së ndërtimit.</i>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është të njohë studentët me rëndësinë dhe karakteristikat e procesit të integruar të projektimit në krahasim me problemet e zgjedhjes së llojit të qendrës së komunitetit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Njoh rëndësinë e ndërtesave të projektimit të qendrave të komunitetit; - Zhvilloj qasje kërkimore dhe hulumtuese; - Integroj dhe prezantoj njohuritë e fituara; - Hulumtoj dhe shfrytëzoj materiale dhe teknologji tradicionale dhe bashkëkohore në projektimin arkitektonik; - Zhvilloj qasje krijuese në përdorimin dhe zgjidhjen e teknologjive konstruktive dhe zbatimin e tyre;
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	3	2	6
Përgatitje për test intermediar	/	/	/
Konsultime me mësimdhënësin	0.2	5	1
Puna në terren	3	2	6
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	3	2	6
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	4	3	12
Përgatitja për provimin final	2	2	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	3	3	9
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
Total			99 - 4 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentimi analitik dhe krahasimi përmes të mjeteve të konkretizimit si projektori, llaptopi, tabela; ushtrimet e organizuara me punë në grupe (2 deri 3 studentë); vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.		
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%)		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Purini, F., Competition Ideas for the Italian Pavilion at Expo Shanghai 2010: The Future of Cities is "Made in Italy", ISBN-10: 8849219342, ISBN-13: 978-8849219340. Publisher: Gangemi Editore (December 3, 2010). 2. Stegers, R., SACRED BUILDINGS (Design Manuals), ISBN-10: 3764366834, ISBN-13: 978-3764366834. Publisher: Birkhäuser Architecture; 1 edition (May 16, 2008). 3. Arnold, E., Why we live in community, 2011, New York, Plough Publishing House Rifton; 4. Designing A Complete Community Center: Responsive Design in a Rural Setting; SIT Graduate Institute/SIT Study Abroad, Spring 5-2012, 		

Literatura shtesë:	<p>5. Progressive Community Design, PROGRESSIVE PLANNING, The Magazine of Planners Network, http://www.plannersnetwork.org/</p> <p>6. COMMUNITY CENTRE MINIMUM SPECIFICATIONS; https://artistscoalition.files.wordpress.com/2012/09/final-community-centre-document.pdf</p>
---------------------------	--

Hartimi i planit mësimor

Sipas dokumentit të veçant.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

- *Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit;*
- *Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara;*
- *Studenti i cili i plotëson të gjitha obligimet nga lënda (vijimi i rregullt i ligjeratave, prezenca obligative dhe puna në ushtrime, maksimum 3 mungesa te arsyeshme) fiton të drejtën për vlerësimin e punimeve dhe projekteve të dorëzuara gjatë semestrit;*

Shënim | Nëse projekti kryesor semestral i një studenti vlerësohet nën 56%, atëherë ai/ajo duhet të përsëritë prap lëndën/do të humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final.